



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



KONTRATË

Numri i kontratës¹: 626-22-2091-2-3-6/C113

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

Dhe

Operatori Ekonomik **A.R.F. SH.P.K.** me numër të biznesit: 811255109 Selia në, **FUSHË KOSOVË rruga Xhevë Lladrovci**, të cilën e përfaqëson z. **Avdi Koca** në cilësinë e drejtorit (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Shtypja e formularëve të ndryshëm për QMF-n dhe Administratën e Komunës së Mamushës, me numër identifikues të prokurimit: 626-22-2091-2-3-6 dhe nr. të brendshëm 626-22-10-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve e cila ka të bëjë me shtypjen dhe furnizimin me formularë dhe materiale tjera zyrtare për QMF-n dhe Administratën e Komunës së Mamushës.

" Shtypja e formularëve të ndryshëm për QMF-n dhe Administratën e Komunës Mamushës "				
Nr.	Përshkrimi	Njësia	sasia	AK ²
1.	Urdhëresë Për Dhënie e Terapisë Parenterale- A4	Tubë-Bllok	60	
2.	Udhëzim Për Konsultim-Bllok A4 Thjesht Porosi	Tubë-Bllok	20	
3.	Shtypje Libër protokolli A4 Imitex me 14 fusha, në dy faqe. X 200 faqe	Copë	30	
4.	Fletëza kompjuterike Shëndetësore (SISH 001) - A4	Tubë-Bllok	40	
5.	Raport Kthyes nga Laboratori-A4	Tubë-Bllok	20	
6.	Udhëzim Për Hulumtime Diagnostike-A4	Tubë-Bllok	40	
7.	Recetë për Barna A5	Tubë-	70	

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Mos e përdor këtë kolonë që është e rezervuar për Autoritetin Kontraktues për procesin e vlerësimit.

		Blllok		
8.	Kontrolli i Urinës 10x30 cm	Tubë-Blllok	20	
9.	Kartela e imunizimit- Ngjyra e kaltert x1 faqe A5	copë	110	
10.	Dëftesa me Numrat Rendor dhe me 3 kopje A4	Tubë-Blllok	30	
11.	Raport për Pushim mjekësor A4	Tubë-Blllok	15	
12.	Shtypja dhe furnizimi me dosje të fajllave (folder), në ngjyra, me kuti. 80mm gjerësi e përshtatshme për madhësi të letres A4. Duhet të shtypet shkrimet dhe logo e Komunes së Mamushës dhe logo e Republikës së Kosovës në ballë të dosjes. Tekst duhet të shkruhet në katër gjuhë si më poshtë.  Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova – Republic of Kosovo  Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa	copë	200	

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **15 (pesëmbëdhjetë)** ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 **Vendi kryesor i realizimit është: Shtypja e formularëve do të bëhet në zyrat e Operatorit ekonomik, ndërsa dorëzimi do të bëhet në QMF dhe në Kuvendin Komunal në Mamushë.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP³ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **888,50 €; Tetëqind e tetëdhjetë e tetë Euro e pesëdhjetë Eurocent.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

³ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Inspektimi dhe testimi

7.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 8 Nën-kontraktimi

8.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

10.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

11.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

11.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 12 Komunikimi

12.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues


Emri:	Avdi Koca	Emri:	Gazmend Gashi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	19.04.2022	Data:	19.04.2022
Vula:		Vula:	





REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



PJESA II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Titulli i Tenderit: “Shtypja e formularëve të ndryshëm për QMF-n dhe Administratën e Komunës së Mamushës”

Nr. i Prokurimit ¹	626-22-2091-2-3-6
Nr i brendshëm	626-22-10-2-3-6

Shtypja e formularëve të ndryshëm për QMF-n dhe Administratën e Komunës së Mamushës

Artikul	Përshkrimi i artikullit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1.	Urdhëresë Për Dhënien e Terapisë Parenterale- A4	Tubë-Blok	60.00	1.40	84.00
2.	Udhëzim Për Konsultim-Blok A4 Thjesht Porosi	Tubë-Blok	20.00	1.40	28.00
3.	Shtypje Libër protokolli A4 Imitex me 14 fusha, në dy faqe. X 200 faqe	Copë	30.00	3.00	90.00
4.	Fletëza kompjuterike Shëndetësore (SISH 001) - A4	Tubë-Blok	40.00	1.40	56.00
5.	Raport Kthyes nga Laboratori-A4	Tubë-Blok	20.00	1.40	28.00
6.	Udhëzim Për Hulumtime Diagnostike-A4	Tubë-Blok	40.00	1.40	56.00
7.	Recetë për Barna A5	Tubë-Blok	70.00	1.30	91.00
8.	Kontrolli i Urinës 10x30 cm	Tubë-Blok	20.00	1.30	26.00

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

9.	Kartela e imunizimit- Ngjyra e katërt x1 faqe A5	copë	110.00	0.30	33.00
10.	Dëftesa me Numrat Rendor dhe me 3 kopje A4	Tubë-Blok	30.00	1.50	45.00
11.	Raport për Pushim mjekësor A4	Tubë-Blok	15.00	1.30	19.50
12.	Shtypja dhe furnizimi me dosje të fajllave (folder), në ngjyra, me kuti. Gjerësi e përshtatshme për madhësi të letres A4. Duhet të shtypet shkrimet dhe logo e Komunës së Mamushës dhe logo e Republikës së Kosovës në ballë të dosjes. Tekst duhet të shkruhet në katër gjuhë si më poshtë.  Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti Republika Kosovo – Republic of Kosovo  Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa	Copë	200.00	1.66	332.00
Totali i përgjithshëm duke aplikuar të gjitha taksat dhe tatimet					888.50
Vërejtje: Një Tubë ose bllok duhet të ketë 100 copë letër dhe duhet të ketë mbështjellësin. Fituesit të tenderit do t'ia dërgojmë mostrat për shtypje para porosisë të materialit.					

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	ARF SHPK
ADRESA E PLOTE	RR.XHEVE LLADROVCI
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	AVDI KOCA
POZITA	DREJTOR
NËNSHKRIMI	
DATA	28.03.2022
VULA	